



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 56

Datë: 01.12.2020. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Artan Asllani, Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
 - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.49/2020
2. Aktivitetet e SKQZ-së.
3. Informatë nga QNR-ja.
4. Të ndryshme.

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Përshëndetje, kemi kuorum...A ka dikush diçka, përkundër rendit të ditës...? Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës dhe pastaj, edhe procesverbalin nga mbledhja nr.49/2020.

2. Aktivitetet e SKQZ-së:

Burim Ahmetaj: Sekretariati, mbas zgjedhjeve të mbajtura në dy komunat më 29 nëntor, në Podujevë dhe në Mitrovicë, jemi në procesin e përpunimit të të gjitha të dhënave në mënyrë që t'i kemi ta kemi rezultatin përfundimtar. Raportin e kemi para vetës, dhe aty janë të gjitha listimet e aktiviteteve që, do t'i zbatojmë gjatë këtij muaji deri në përmbyllje të vitit.

Po ashtu, kemi kërkuar nga departamentet të kemi nga një raport të këtyre zgjedhjeve. Mbi këto raporte, do ta bëjmë vlerësimin e procesit. Kemi një informacion – ftesë nga Komisioni Buxhet dhe Transfere që, KQZ të raportoj raportin financiarë...

Valdete Daka: Do të ishte mirë ta kemi një raport mbi materialet zgjedhore mbas përfundimit të procesit zgjedhorë, për pasuritë që janë blerë nga KQZ-së...? Pra, është mirë ta kemi një pasqyrë se cka ka mbetur, cilat materiale nga procesi zgjedhor...?

Alim Rama: Kam një kërkesë: Janë listat në komunën e Prizrenit nga procesi zgjedhor 2019 që ende nuk janë shlyer pagesat për këshillat e Vendvotimeve...? Ta kemi një raport se sa janë...!

Burim Ahmetaj: Në këtë muaj, do t'i kemi parasysh të gjitha pagesat që nuk janë bërë, krahas këtyre të zgjedhjeve të fundit...

3. Informatë nga QNR-ja:

Burim Ahmetaj: Janë disa çështje ku duhet vendimmarrje...nga KQZ. Raportin e kemi pasur, mirëpo janë procedura që duhet respektuar, dhe ne sapo ta marrim miratimin e KQZ-së, do të procesojmë më tej...Fjala është për materialet që kanë përfunduar në karantinë, pra materiale që nuk kanë mundur të procesohen s'i të rregullta...

Janë edhe 7 rekomandime: 2 rekomandime lidhen me VV –të e rregullta, dhe 5 të tjera kanë të bëjnë me Zarfet e fletëvotimeve me kusht, dhe numri i tyre është i vogël...

Arianit Elshani: Do të kërkoja që ky vendim, para se të nënshkruhet të shikohet, të riformulohet edhe njëherë... Mund të ketë lëshime, ndonëse ato mund të jenë edhe tenkike... Pra, kërkohet pak më shumë qartësi në tekst...

Valdete Daka: Ne, në pako mund ta votojmë...! Kush është për..?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.

1. Të ndryshme.